



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 20.4.2026

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 10, datë 15.1.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si më poshtë vijon:

- **DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)
- **Detyrat kryesore:**
- Përditëson në vijimësi dosjet e personelit në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
 - Regjistron dhe ndjek procedurat e përfundimit të marrëdhënieve të punës për punonjësit dhe nëpunësi civil të Agjencisë.
 - Mbledh të dhëna nga drejtoritë përkatëse dhe përpilon listë prezencën mujore të punonjësve të Agjencisë duke e dërguar në Drejtorinë e Financës.
 - Llogarit vjetërsinë në punë të punonjësve dhe e përcjellë pranë Drejtorisë së Financës për çdo muaj.
 - Harton listën me nevojat e stafit për trajnim dhe përditëson ditarin vjetor me trajnimet e përfituara të stafit.
 - Përgatit/koncepton letra të ndryshme, urdhra, njoftime dhe dokumente të tjera në funksion të veprimtarisë së drejtorisë dhe Agjencisë.
 - Organizon punën për trajnimin e stafit në periudhë prove dhe asiston në trajnime të ndryshme të organizuara për stafin e ri.
 - Asistoni në ndjekjen e procesit të punës për vlerësimin e rezultateve në punë të stafit të Agjencisë.
 - Mbikëqyr dhe përditëson kartelat e mirëmbajtjes së automjeteve.
 - Siguron që automjetet të jenë në gjendje teknike/mekanike për përdorim sipas nevojave të Agjencisë.
 - Njek dhe siguron kontrollin periodik për gjendjen teknike të makinerive dhe pajisjeve duke bërë propozime konkrete për eprorin.

- Ndhomon në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, që lidhen me mirëmbajtjen e ndërtesës së institucionit.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

- Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Shoqërore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar;
- VKM nr. 719, datë 31.10.2014, "Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural", të ndryshuar;
- Ligji nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Ligji nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 24.4.2026, ora 14:00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjolleša”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL